



BULETIN



RRITJA E PJESËMARRJES SË PUBLIKUT NË PROCESIN LEGJISLATIV

Buletin dyjavor / Nr.5

Maj 2004

Projekt i Qendrës së Studimeve Parlamentare dhe Programit të Drejtësisë, Fondacioni Shoqëria e Hapur (SOROS)

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

I. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 30.4.2004.

PROJEKTLIGJE

Vendime për miratim të propozimit të projektligjit Kuvendit të Shqipërisë.

1. Për legalizimin e zonave informale. Me këtë projektligj synohen të zgjidhen probleme që kanë të bëjnë me tokat bujqësore të kthyer ne troje ndërtimi; përcaktimi se çfarë do të quhet zonë informale dhe se do të jetë maksimumi i njësisë së banimit, si dhe probleme lidhur me pronësinë.

2. Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe të ndërmjetësimit në sigurinë dhe risigurinë. Ky projektligj synon forcimin e rregullave të licensimit të shoqërive të sigurimit dhe risigurimit, forcimin e rregullave të mbikqyrjes së këtyre shoqërive, shtimin e instrumenteve të mbikqyrjes, përcaktimin e rregullave për likuidimin e shoqërive të sigurimit dhe risigurimit etj.

3. Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të Sigurimeve. Ky projektligj synon rritjen e pavarësisë institucionale dhe operacionale të Komisionit Mbikqyrës të Sigurimeve, me qëllim ushtrimin e

funksioneve dhe kompetencave të tij në mbrojtje të interesave të të siguruarve.

4. Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr 8975, datë 21.11.2002 “Për trajtimin e faturave tatimore te ujit të pijshëm si titull ekzekutiv”.

Shtesa dhe ndryshimi në ligjin në fuqi bëhet për të reflektuar ndryshimet që janë bërë në procesin e bashkimit të ndërmarrjeve të ujës-jellës dhe kanalizimeve që kanë formuar një njësi menaxhimi ujës-jellës-kanalizime.

5. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr 8749, datë 1.3.2001, “Për Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Rendit Publik”. Bazuar në përvojën tre vjeçare të zbatimit të këtij ligji, ndryshimet dhe shtesat bëhen për të rritur efikasitetin e kësaj strukture.

6. Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Menaxhimi i mbetjeve urbane të Tiranës”. Marrëveshja është nënshkruar në Tiranë më 26 Mars 2004.

(Vijon në faqen 2)

Në këtë numër do të lexoni:

**1. Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave
faqe 1-2**

**2. Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore
faqe 1**

**4. Nga punimet e Kuvendit për periudhën 1-15 maj 2004
faqe 3-4**

**5. Kalendari 2 javor i Kuvendit, 10 - 20 maj 2004
faqe 5-7**

Informacion mbi faqet e internetit të Institucioneve Qëndrore

Kuvendi i Shqipërisë
www.parlament.al

Këshilli i Ministrave
www.keshilliministrave.al

Presidenca
www.president.al

Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
www.mash.gov.al

Ministria e Punëve të Jashtme
www.mfa.gov.al

Ministria e Shëndetësisë
www.moh.gov.al

Ministria e Rendit Publik
www.mpo.gov.al

Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
www.mpvd.gov.al

Bashkia e Tiranës
www.tirana.gov.al

Nga Mbledhjet e Këshillit të Ministrave

(Vijon nga faqja 1)

Mbas përmbushjes së kërkesave ligjore të hyrjes në fuqi të saj do të fillojë të zbatohet programi i cili synon reduktimin e rrezikut ndaj mjedisit dhe shëndetit në rajonin e Tiranës.

Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zonave në pyje dhe kullota.

2. Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë së kandidatave alternative për anëtar të Komisionit të Konkurrencës.

3. Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr. 416, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, "Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit nga privatizimi i shoqërisë tregtare që veprojnë në sektorë jostrategjikë".

4. Për një shtesë në vendimin nr. 617, datë 4.12.2002 të Këshillit të Ministrave "Për heqjen nga armatimi dhe përdorimi të një pjese të armëve, teknikës dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe për asgjësimin ose çarmatimin dhe shitjen e tyre".

5. Për miratimin në parim të antarësimit të Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen Wassenaar "Për kontrollin e eksportit të armëve konvencionale, të mallrave dhe teknologjive në përdorim të dyfishtë".

6. Për miratimin në parim të memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë, për stërvitjen "Adriatic Phiblex 2004-02 Engineerex".

7. Për miratimin e akteve dhe të dokumenteve kryesore të Kongresit të Bashkimit Postar të Përbotshëm, Pekin, 1999.

8. Për miratimin në parim të konventës "Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale".

9. Për miratimin në parim të protokollit shtesë të konventës "Për

mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave".

10. Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Sllovenisë, për bashkëpunim shkencor dhe teknologjik.

11. Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2004, miratuar për Kryeministrinë, për Komitetin Shtetëror të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve.

12. Për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror zotit Telat Agolli. Për dhënie fondi ndihmë banorëve të fshatit Nimçe, komuna Topojan, dhe të fshatit Lomje, komuna Zapod, të Qarkut të Kukësit, të cilëve u janë shkatërruar banesat nga rrëshkitja e tokës.

13. Për emërim në detyrë të prefektit të Qarkut të Gjirokastrës.

II. Mbledhja e Këshillit të Ministrave e datës 7.5.2004.

PROJEKTLIGJE

Vendime për miratim të propozimit të projektligjit Kuvendit të Shqipërisë.

1. Për veterinarinë.

Me këtë projektligj synohet të realizohet harmonizimi i të gjitha normave e praktikave të mjeksisë veterinarë në Shqipëri; gjithashtu ai synon të plotësojë të gjitha mangësitë e boshllëqet e krijuara nga ligji ekzistues, si dhe përfshirjen e një sërë çështjes të reja që s'ka nxjerrë koha, duke hedhur hapa të rëndësishme në procesin e përafrimit të legjislacionit të vendit tonë me atë të BE-së.

2. Për disa ndryshime në ligjin nr.8553, datë 25.11.1999 "Për policinë e shtetit", të ndryshuar. Bazuar në angazhimet tona në kuadër të Procesit të Stabilizim Asocimit, si dhe praktikën e deritanishme, ky projektligj synon të krijojë mundësinë e ndërtimit të strukturave adekuate dhe të specializuara policore në luftën

kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikeve të paligjshme.

Vendime të Këshillit të Ministrave

1. Për miratimin e strategjisë kombëtare antidrogë, 2004-2010.

2. Për dhënie fondi ndihmë disa njësive të qeverisjes vendore, për përmirësimin e infrastrukturës.

3. Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Komitetit Shtetëror të Ministrave të disa mjediseve, për ushtrimin e veprimtarisë së këtij komiteti.

4. Për dhënie mendimi Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për projektligjin joqeveritar "Për ndryshim në ligjin nr 8677, datë 2.11.200, "Për organizimin dhe funksionimin e Policisë gjyqësore".

5. Për miratimin në parim të protokollit shtesë të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në Partneritetin për paqe, për sa i përket statusit të forcave të tyre.(SOFA).

6. Për miratimin në parim të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe drejtorive kombëtare për kodifikimin, të grupit të NATO-s (AC/135), për antarësimin në sistemin e kodifikimit të NATO-s (NCS).

7. Për miratimin në parim të marrëveshjes ushtarake grant, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Turqisë.

8. Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federative të Brazilit, për heqjen e pjesshme të vijave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare ose të shërbimit.

9. Për miratimin e strategjisë kombëtare të ujit.

10. Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të komunës Hudenisht.

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 1-15 MAJ 2004

1. Projektligji “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”

Ky projektligj synon të realizojë decentralizimin e administrimit dhe të menaxhimit të strehimit, duke u dhënë organeve të qeverisjes vendore disa kompetenca në fushën e strehimit, si dhe të krijojë mundësinë për hartimin e programeve sociale të strehimit. Projektligji mbështetet në tri tipe programesh sociale të strehimit, që janë programet e banesave sociale me qira, programet e banesave me kosto të ulët dhe programet e pajisjes së tokës me infrastrukturë dhe përcakton procedurat për secilin program. Në të parashikohen edhe rastet e subvencionimit të qirasë ose të interesave të kredive nga shteti. Gjatë diskutimit të projektligjit në komisionet e përhershme të Kuvendit dhe në seancë plenare, deputetët e miratuan atë në parim, duke theksuar se miratimi i një ligji të tillë i hap rrugën Qeverisë dhe organeve të pushtetit vendor që, në varësi të burimeve financiare, të ndërmarrin hapa për zbutjen graduale të problemit të strehimit, i cili është bërë shqetësues, veçanërisht në qytete, ku ka përqëndrim më të madh të popullsisë.

Deputetët shfaqën mendime për ndryshimin ose riformulimin e disa neneve të projektligjit, për ta përmirësuar përmbajtjen e tij.

Një nga nenet që u debatua është neni 25 i projektligjit, i cili bën fjalë për subvencionimin nga shteti të interesave të kredive. Sipas projektligjit, familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët kanë të drejtën e marrjes së një kredie hipotekore me kushte lehtësuese nga një institucion financiar që ka lidhur kontratë me Ministrinë e Financave. Kushtet e dhënies së kredisë nga bankat përcaktohen nga Ministria e Financave, ministria që mbulon fushën e strehimit dhe institucioni që jep dhe menaxhon kredinë.

Disa deputetë shprehën mendimin se kushtet e dhënies së kredisë duhet t'i përcaktojë institucioni që ka dhënë kredinë, pra banka, jo Ministria e Financave. Disa deputetë të tjerë u shprehën që të drejtën e marrjes së kredisë në bankë duhet ta ketë personi i interesuar dhe jo shteti. Sipas tyre, në bazë të kontratës që

personi i interesuar lidh me bankën kur merr kredinë, shteti duhet të subvencionojë interesat e kredisë. Kundërshtuesit e këtij mendimi theksuan se shteti subvencionon interesat e kredive për një pjesë të familjeve, jo për të gjitha, prandaj procedura e dhënies së kredisë nuk mund të jetë direkte, bankë me familje. Për këtë shteti harton programe sociale, duke i dhënë të drejtë Ministrisë së Financave të lidhë marrëveshje me bankat për të marrë kredi, të cilën do ta përdorë për programet sociale të strehimit. Për këtë arsye, theksuan ata, kushtet e dhënies së kredisë përcaktohen nga Ministria e Financave, në marrëveshje me ministrinë që mbulon fushën e strehimit dhe me bankën.

Me këto argumente, Kuvendi miratoi formulimin e projektligjit për këtë çështje.

Një çështje tjetër, për të cilën u debatua ka të bëjë me nenin 30 të projektligjit, i cili parashikon burimet e financimit të programeve sociale të strehimit. Disa deputetë ngritën shqetësimin se në këtë nen nuk është parashikuar si burim financimi kredia që shteti ka të drejtë të marrë në banka, e cila, sipas tyre e bën ligjin deklarativ dhe të pazbatueshëm. Ky mendim u kundërshtua nga specialistët dhe u mbështet nga shumica e deputetëve, të cilët u shprehën se ky burim financimi është përfshirë në pikën “b” të këtij neni.

Në përfundim të diskutimit, Kuvendi miratoi formulimin e projektligjit për këtë çështje.

Kuvendi miratoi ndryshimin e nenit të 20 të projektligjit, i cili vendos disa kufizime ndaj familjeve që kanë përfituar banesë me kosto të ulët. Sipas projektligjit, familja që ka përfituar banesë me kosto të ulët dhe e ka shlyer atë me pagesë të menjëhershme, duke u bërë pronare e saj, detyrohet të mos e shesë banesën për një periudhë 10-vjeçare. Ndryshimi konsiston në afatin, brenda të cilit familja nuk lejohet ta shesë banesën, i cili nga 10 vjet bëhet 15 vjet dhe në kushtin që pagesa të jetë shlyer, jo domosdoshmërisht në mënyrë të menjëhershme.

(Vijon në faqen 4)

NGA PUNIMET E KUVENDIT PËR PERIUDHËN 16-30 PRILL 2004

(Vijon nga faqja 3)

Kuvendi miratoi edhe një sërë ndryshimesh të tjera në formulimin e neneve të projektligjit.

2. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit të formës “BOT” për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar në Gjirin e Vlorës”

Projektligji parashikon ratifikimin nga Kuvendi të dy marrëveshjeve koncesionare midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Shoqërisë Italiane “La Petrolifera Italo Rumena SPA”. Marrëveshja e koncesionit e formës “BOO” ka si objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e terminalit bregdetar për depozitimin e naftës dhe të nënprodukteve të saj në Gjirin e Vlorës, ndërsa marrëveshja e koncesionit e formës “BOT” ka si objekt ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të këtij terminali bregdetar. Afati i koncesionit parashikohet të jetë 30 vjet me të drejtë ripërtëritjeje.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit, disa komisione të përhershme të Kuvendit, u shprehën në parim dakord me miratimin e tij. Sipas tyre, ratifikimi i këtyre marrëveshjeve do të sjellë rritje të konkurrencës dhe ulje të çmimit të naftës dhe të gazit të lëngshëm në treg dhe do ta shndërrojë Vlorën në një nyje të rëndësishme energjitike rajonale. Gjithashtu, ata vlerësuan efektet pozitive të këtyre marrëveshjeve në uljen dhe minimizimin e faktorëve ndotës të mjedisit.

Krahas vlerësimit të mësipërm, për këtë projektligj pati edhe një vlerësim tjetër nga Komisioni i Ekonomisë, Financave dhe Privatizimit, ku deputetët ngritën shqetësimin se disa

formulime në tekstin e marrëveshjes lenë shkas për keqkuptime dhe cënim të parimeve të konkurrencës së lirë.

Kështu, në nenin 8 të Marrëveshjes thuhet që terminali dhe zona e koncesionit portual të jetë i vetmi terminal dhe e vetmja infrastrukturë portuale për depozitimin dhe transportimin (nga brenda dhe nga jashtë, nga toka dhe nga deti) e naftës, produkteve të naftës, produkteve të gazeve të lëngshëm dhe të produkteve të tjera të lëngshme në Gjirin e Vlorës, si dhe një sërë të drejtash të tjera ekskluzive për përdorimin e infrastrukturës ekzistuese, duke kush-tëzuar që të mos ndërtohet asnjë infrastrukturë e re tjetër, përveç asaj që do të ndërtohet nga koncesionari. Gjithashtu, koncesionarit i bëhen një sërë lehtësirash fiskale.

Komisioni i Ekonomisë kërkoi nga përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave që, së bashku me koncesionarin, të korrigjojnë marrëveshjen, duke hequr nga teksti i saj të drejtën ekskluzive të koncesionarit për transportin e naftës dhe të nënprodukteve të saj dhe duke i ndaluar atij veprimtarinë e tregtimit të karburanteve.

Pas miratimit nga Këshilli i Ministrave të ndryshimeve të mësipërme në tekstin e marrëveshjes, Komisioni i Ekonomisë e miratoi projektligjin për të kaluar në seancë plenare.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në seancë plenare deputetët e opozitës e kundërshtuan atë, për shkak të së drejtës ekskluzive që i jepet një subjekti të vetëm për këtë objekt koncesioni, ndërkohë që, sipas tyre, për të kanë shprehur interes edhe subjekte të tjera. Kjo e drejtë, sipas tyre, dëmton konkurrencën e lirë në treg.

Deputetët e maxhoranës e kundërshtuan këtë qëndrim të opozitës, duke vlerësuar Shoqërinë Italiane “La Petrolifera Italo Rumena SPA” si një kompani prestigjioze dhe me reputacion ndërkombëtar në këtë fushë. Ata theksuan se Këshilli i Ministrave ka dërguar zyrtarisht tekstin e marrëveshjes të korrigjuar sipas propozimeve të Komisionit të Ekonomisë.

Në përfundim, deputetët e opozitës u larguan nga salla dhe projektligji u miratua, duke përfshirë ndryshimet në tekstin e marrëveshjes, sipas propozimeve të Komisionit të Ekonomisë.

KALENDARARI

2 JAVOR (10 - 20 MAJ 2004) I PUNIMEVE TË KUVENDIT

E Hënë, datë 10.05.2004, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Miratimi i Kalendarit 2 javor të punimeve të Kuvendit.
2. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Niko Faber nga Ministri i Bujqësisë dhe Ushqimit.
3. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Shëndetësisë.
4. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Shtetit dhe Koordinimit.
5. Raport i Qeverisë për Shërbimin Civil 2003.
- Pyetje dhe diskutime.

E Martë, datë 11.05.2004

E Mërkurë, datë 12.05.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji “Për ratifikimin e udhëzimeve dhe Kodit të Procedurave të Nismës së Europës Qendrore (NEQ)”.
-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)
-Komisioni i Jashtëm
2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Periferitë urbane të Tiranës - komponenti i Infrastrukturës”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Industrisë

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Shëndetësisë dhe Mjedisit

3. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për financimin e fazës së dytë të projektit të spitalit të përgjithshëm Durrës”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Shëndetësisë dhe Mjedisit

4. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

5. P/Ligji “Për punën e Kuvendit në procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin European” (paraqitur nga deputeti I.Zela).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Integritit

-Komisioni i Rendit

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Bujqësisë dhe Ushqimit

-Komisionet e tjera

6. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr.8894, datë 14.5.2002 “Për Agjensinë e Trajtit të Kredive” të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

7. P/Ligji “Për disa shtesa në ligjin nr. 7973, datë 26.7.1995 “Për koncensionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve (e ka shqyrtuar)

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

-Komisioni i Industrisë

8. P/Ligji “Për një ndryshim në ligjin nr.8701, datë 1.12.2000 “Për lojërat e fatit, kazinotë dhe hipodromet”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe Financës

9. P/Ligji “Për miratimin e Kodit Detar Shqiptar”.

(Vijon në faqen 6)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 5)

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Mbrojtjes

-Komisioni i Industrisë dhe

Telekomunikacionit

-Komisioni i Shëndetësisë dhe

Mjedisit

10. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993 “Për statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist” të ndryshuar me ligjin nr. 7771, datë 7.12.1993” (paraqitur nga një grup deputetësh).

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

-Komisioni i Punës dhe

Çështjeve Sociale

-Komisioni i të Drejtave të

Njeriut

11. Dekret nr. 4217, datë 3.05.2004 “Për dhënie pëlqimi për emrimin e zotit Gjergj Sauli në detyrën e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese”.

-Komisioni i Ligjeve

12. P/Ligji “Për njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronës”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

E Enjte, datë 13.05.2004, ora 10.00

-Seancë Plenare

1. P/Ligji “Për ratifikimin e Protokollit ndryshues të Konventës Europiane për shtypjen e terrorizmit”.

2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncensionit, të Formës “BOO”, për ndërtimin

dhe shfrytëzimin e Terminalit bregdetar, për depozitimin e naftës dhe nënprodukteve të saj, në Gjirin e Vlorës, si dhe për ratifikimin e marrëveshjes së koncensionit të Formës “BOT”, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e infrastrukturës portuale në shërbim të terminalit bregdetar, në Gjirin e Vlorës”.

3. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8353, datë 3.6.1998 “Për ratifikimin e marrëveshjes së huasë, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane të Investimeve, për projektin e Autostradës Vorë-Durrës”.

4. P/Ligji “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”.

5. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e Jetimit” (paraqitur nga një grup deputetësh).

6. Dekreti nr. 4217 date 03.05.2004 “Per dhenie pëlqimi per emerimin e zotit Gjergj Sauli ne detyren e Kryetarit te Gjykares Kushtetuese”.

*** * ***

E Hënë, datë 17.05.2004, ora 18.00

-Seancë Plenare

1. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Kristo Goçi nga Ministri i Rregullimit të Territorit dhe Turizmit.

2. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

3. Përgjigje e pyetjeve të deputetit Nikollë Lesi nga Ministri i Rendit Publik.

E Martë, datë 18.05.2004

E Mërkurë, datë 19.05.2004

- Punë në komisione për shqyrtimin e këtyre p/ligjeve:

1. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, për realizimin e programit “Rehabilitimi dhe paisja e 5 poliklinikave”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Shëndetësisë

-Komisioni i Ekonomisë dhe

Financës

2. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes plotësuese ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të “Marrëveshjes ndërmjet shteteve palë në traktatin e Atlantikut Verior dhe shteteve të tjera pjesëmarrëse në partneritetin për paqe në lidhje me statusin e forcave të tyre mbi statusin e forcave të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë”.

-Komisioni i Ligjeve

-Komisioni i Jashtëm

-Komisioni i Mbrojtjes

(Vijon në faqen 7)

Kalendari dyjavor i punimeve të Kuvendit

(Vijon nga faqja 6)

3. P/Ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikqyrës të sigurimeve”.

-Komisioni i Ligjeve

*-Komisioni i Ekonomisë dhe
Financës*

4. P/Ligji “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësitë në sigurime dhe risigurime”

-Komisioni i Ligjeve

*-Komisioni i Ekonomisë dhe
Financës*

5. P/Ligji “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”.

-Komisioni i Ligjeve

*-Komisioni i Bujqësisë dhe
Ushqimit*

*Komisioni i Shëndetësisë dhe
Mjedisit*

6. P/Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”.

-Komisioni i Ligjeve

*-Komisioni i Bujqësisë dhe
Ushqimit (e ka shqyrtuar)*

7. P/Ligji “Për një shtesë në ligjin nr. 7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive

të panvarura dhe privatizimit”, të ndryshuar.

-Komisioni i Ligjeve

*-Komisioni i Ekonomisë dhe
Financës*

*-Komisioni i Bujqësisë dhe
Ushqimit*

*E Enjte, datë 20.05.2004, ora
10.00*

-Seancë Plenare

1. P/Ligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së kredisë, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Islamike për Zhvillim (IDB), për financimin e fazës së dytë të projektit të spitalit të përgjithshëm Durrës”.
2. P/ligji “Per kthimin dhe kompensimin e pronave. (paraqitur nga deputetet Fatmir Mediu dhe Alfred Çako).
3. P/ligji “Per njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave”. (paraqitur nga nje grup deputetesh).

Njoftim

Të nderuar zonja e zotërinj,
Kuvendi i Shqipërisë me datë 30.06.1999 ka miratuar ligjin nr.8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”. Ky ligj rregullon të drejtën e informimit për çdo person dhe krijon mundësinë për të marrë informacion mbi dokumentat zyrtare. Ligji përcakton gjithashtu detyrimin e autoriteteve publike për krijimin e lehtësirave dhe ngritjen e strukturave praktike që publiku i gjerë të marrë në mënyrë të saktë, të plotë, të përshtatshme e të shpejtë, informacionin mbi dokumentat zyrtare.

Autoriteti publik vihet në lëvizje me kërkesë të personit të interesuar dhe është i detyruar ti krijojë atij të gjitha mundësitë e përcaktuara në këtë ligj, për dhënien e informacionit të kërkuar. Njëkohësisht autoriteti publik që nga momenti i depozitimit të kërkesës është i detyruar, brenda një kohe të përcaktuar në ligj, ta plotësojë atë.

Ligji i jep të drejtën çdo personi të interesuar të ankohet, kur e drejta për informim shkelet nga autoriteti publik. Për të realizuar këtë, ligji përcakton mënyrën dhe rrugët që ky ankim mund të ndiqet nga subjekti i interesuar. Kjo rrugë mund të jetë administrative dhe gjyqësore.

Për të realizuar sa më mirë këtë të drejtë të njohur nga Ligjvënësi Shqiptar, Qendra e Studimeve Parlamentare “QSP” në Tiranë njofton të gjithë të interesuarit si më poshtë;

“Të gjithë individët dhe organizatat të cilët janë viktimë e mohimit të së drejtës për informim, shkeljes së dispozitave të ligjit nr.8503 dt.30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare” do të kenë mundësinë që, pranë QSP, të marrin asistencë ligjore nga një avokat.

Avokati pranë kësaj njësie, do të jetë në dispozicion të subjekteve të sipërpërmendur nga e Hëna në të Enjte ora 15.00 – 17.30

Çdo subjekt i tillë, apo që kërkon informacion më të gjerë mbi këtë të drejtë të sanksionuar me ligj, është i mirëpritur pranë QSP.”

Denada BRESHANAJ

Koordinatorë Projekti/Project Coordinator
Qendra e Studimeve Parlamentare/Centre for Parliamentary Studies
Rr. Sami Frasheri, Pall. e Aviacionit, nr.3/15
Tirana-Albania Tel/Fax: +355 4 240 214; cps@albaniaonline.net;
www.ascdpd.org